

A K T - T H E M E L I M II SHOQERISE NDERTIMORE " B A R D H I " SHPK ME SELI NE L A Ç

## Neni 1

Une Josif Bardhi me banim ne Qytetin Laç, themeloj kete shoqeri Nder-timore, me emertim SHPK " Bardhi " Administrator, ortak i vetem. Kjo shoqeri do te kete Seline e saj ne Qytetin Laç dhe me vone edhe ne rrethe te tjera te vendit me kohe zgjatje per 12 vjet, dhe kapitalin themelor fillestar e ka ne shumën 100.000 leke te reja. Veprimtarine e saj Shoqerija do ta ushtroje na ato raste dhe fusha qe parashikohen ne Statutin e saj.

## Neni 2

Shoqerija eshte person juridik dhe do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te ligjes 7512 dt.10.8.1991, te ligjes nr.7638 dt.19.11.1992, si dhe te Kodit Civil te RSH dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore qe kane dalur ne zbatim te tyre.

Shoqerija pergjigjet per detyrimet e saj vetem me porosite e saj, ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe kane punonjesit e shoqerise jashte aktivitetit te shoqerise.

## Neni 3

Kapitali themelor fillestar i Shoqerise eshte 100.000 leke te reja, ky kapital do te rritet sipas shtimit te aktivitetit dhe rritjes te te ardhurave. Shtesa do te derdhet menjehere dhe te rregjistrohet ne rregjistrin themeltar te Shoqerise dhe ne rregjistrin e ortakeve.

## Neni 4

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i aktivitetit te shoqerise do te administrohet nga administratori. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit te shoqerise.

Shoqerija eshte e detyruar te shlyeje ne kohe te gjitha teksat dhe detyrimet e tjera qe ka ndaj shtetit.

## Neni 5

Mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ekzekutimit te ketij akt-themelimi, ne qoftese nuk zgjidhen ne rruge bisedimesh do te zgjidhen me konflikt gjyqesor nepermjet Gjykates se rrethit perkates.

## Neni 6

Objekti i veprimtarise se Shoqerise Ndertimore private " Bardhi " SHPK - Administrator i vetem eshte percaktuar ne nenin 2 te Statutit qe i bashkalidhet ketij akti-themelimi.

## Neni 7

Administrator ligjor i Shoqerise Ndertimore private " Bardhi " esht



Notari i vetem Josif Bardhi.

Neni 8

Per problemet qe nuk jane trajtuar ne kete akt - themelimi do te zbatohen dispozitat ligjore qe parashokohen nga Ligji nr.7638 dt.19.11.1992. " Per Shoqerite Tregtare " dhe Kodi Civil i RSH.

Neni 9

Ky akt - themelimi hyne ne fuqi me rregjistrimin e Firmes Ndertimore re SHPK 2 Bardhi " ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se rrethit te Tiranes, ky Akt - Themelimi redaktohet ne disa kopje, nga te cilat njeren kopje e mban Noteri qe kryen veprimin noterial, nje kopje e mban Gjykata e rrethit Tiranes qe kryen rregjistrimin e Shoqerise si person juridik, dhe nje kopje i dorezohet Zyres perkatese Tatimore dhe dokumentet e tjere respektiv me kopjen e fundit te ketij Akt - Themelimi mbetet si pjese e dokumentacionit te Shoqerise Private Ndertimore " SHPK 2 Bardhi ".

T H E M E L U E S I  
ADMINISTRATOR I VETEM LIGJOR

Josif Bardhi

L A Ç  
me 7.3.1995.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
N O T E R I - Valentin Lleshi-

Laç, me 7.3.1995.

L A Ç  
Nr. 1106 Rep.  
Nr. 684 Kol.

V E R T E T I M

Ne Laç, me 7.3.1995, perpara meje noterit Valentin Lleshi u paraqit Z. Josif Bardhi i cili nenshkroj ne pranine time Aktin e Themelimit te Shoqerise Ndertimore SHPK " Bardhi " me Seli ne Laç. Pasi gjeta aktin sa siper te bazuar ne ligj dhe ne vullnetin e lire te themeluesit vertetoj nenshkrimin e tije sipas kerkesave te ligjes.

N O T E R I

Valentin Lleshi



AVOKAT

Nikoll Kola  
LAÇ

## S T A T U T I

### I SHOQERISE PRIVATE " BARDHI " ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR SHPK ME SELI NE QYTETIN L A Ç

Ne mbeshtetje te Ligjeve nr.7512,dt.10.8.1991 dhe nr.7638 dt.19.11.1992, si dhe te Ligjes nr.7667 dt.28.1.1993 " Per shoqerite tregetare" une Josif Bardhi si themelues i Shoqerise Private Ndertimore SHPK sot me date 7.3.1995 duke pasur edhe zotesine te plote juridike per te vepruar, shpalli per sa vijon:

" Formimin e Shoqerise Private Ndertimore " Bardhi " SHPK me Seli ne Qytetin e Laçit ".

#### F O R M I M I

##### Neni 1

Formohet Shoqerija Private Ndertimore " Bardhi " SHPK me themelues Z. Josif Bardhi, i biri i Palit dhe i Mares i dl, 9.11.1957, lindur dhe banues ne Qytetin Laç, i martuar me 2 femije, me arsim te mesem, me profesion Teknik Ndertimi me zotesi te plote per te vepruar.

#### QENDRA E SHOQERISE

##### Neni 2

Qendra e Shoqerise private ndertimore " Bardhi " do te jete ne Qytetin e Laçit, por me kalimin e kohes dhe ne qytete te tjera te vendit.

#### KOHEZGJATJA E VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

##### Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise private ndertimore "Bardhi" eshte e pakufizuar dhe mund te zgjase 12 vjet, por edhe mund te shperbehet per pak kohe dhe per çdo shkak.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

##### Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise ndertimore " Bardhi " eshte per: Sherbime publike, riparime te pjeseshme dhe te pergjitheshme banesash private dhe shteterore. Mirmbajtje rruges, trotuaresh dhe kanalizime. Ndertime banesash shteterore dhe private dhe objekteve te tjera te çdo lloje. Prodhome parafabrikate te ndryshme e te tjera. Ndertime urash dhe rruges. Ndertim Ujsijellesish dhe te tjera.

#### KAPITALI I SHOQERISE

##### Neni 5

Kapitali i shoqerise, si fillim eshte 100.000 leke te reja, kontribut i vete themeluesit te shoqerise " Bardhi" dhe vete atij ai eshte pronar i ketij kapitali. Kapitali i kesaj shoqerije SHPK do te shtohet

ose do te paksohet me kalimin e kohes, sipas vendimeve qe do te marre pronari i saj.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6

Shoqerija private " Bardhi " deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ne ato te legjislacionit Shqiptar ne fuqi. Ajo eshte krijuar dhe do te vepruje ne perputhje me Ligjin nr.7512 dt.10.8.1991, Per shoqerite tregtare, sanksionimin e mbrojtjen e prones private, nisemes se lire te veprimtarise private dhe te privatizimit, te ligjit nr.7638 dt.19.11.1992 " Per shoqerite private tregtare, si dhe te ligjeve te tjera qe do te shpellen ne te ardhemen per kete qellim, si dhe te Kodit Civil te RSH.

Shoqerija private " Bardhi " vepron si person juridik qe nga data e rregjistrimit te saj ne Gjykatën e rrethit te Tiranës, ndersa do te ushtrroje veprimtarine e saj me marrjen e leje se veprimtarise private ne Zyra perkatese tatimore.

Neni 7

Shoqerija private " Bardhi " ka vulen e saj me mbishkrimin:  
SHOQERIA PRIVATE NDERTIMORE 2 " BARDHI " - LAÇ ( ALBANIA ).

Neni 8

Shoqerija private " Bardhi " vepron ne rregjim te punes private dhe merr persiper te drejta e detyrime. Ajo pergjigjet dhe per detyrimet e saj kontraktore dhe jashte kontraktore brenda kapitalit te saj te fituar.

Neni 9

Shoqerija private " Bardhi " eshte e krijuar si prone e veteme e zotit Josif Bardhi. Vendimet qe merren nga pronari aktual si dhe ato vendime qe merren ne rastet e bashkimit te aktiviteteve te kesaj shoqerije me ortake te tjere, si bashkepronar, ne zbatim te ligjeve ne fuqi, sipas ketij statuti jane te detyrueshme per te gjithë administratorët dhe te punesuarit ne kete shoqeri.

Neni 10

Administratori i kesaj shoqerije, i cili eshte njohesisht edhe pronari i saj, Z. Josif Bardhi, sipas neveojave qe paraqiten, per zhbllimin e veprimtarise se shoqerise ( ekonomike dhe financiare ) emeron administrator ne qender dhe ne deget e shoqerise si dhe puneson punetor sipas nenit 4 te ketij statuti, duke respektuar ligjin " Mbi Marrredheniet e Punës."

## Neni 11

Administratori i Shoqerise dhe me autorizimin e tij administratorët e emeruar prej tij janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshme dhe të jashtëzakonshme, pa asnjë llogje përjashtimi dhe i kanë mundësitë të kryejnë të gjithë aktet që konsiderohen të nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqerise. Ata kanë të drejta, midis të tjerash, të blejnë, të shesin, të këmbejnë pasuri, lende të para, të lidhen me veprimtarinë e shoqerise, të lidhen me shoqerite të tjera, qofshin keto të vendit dhe të huaja, duke siguruar pjesëmarrjen për qëllimin e veprimtarisë së sipërpermendur në nenin 4 të këtij statuti si dhe të kryejnë çdo llojë veprimi pranë të gjithë institucioneve shtetërore e private, institucioneve banakre e financiare, hipotekore dhe të çdo lloji tjetër. Në keto raste administratorët e ngarkuar nga pronari i shoqerise kanë për detyrë ta njoftojnë atë dhe ti japin llogari atij.

## Neni 12

Pronari i shoqerise cakton administrator, të cilet, në aktin e emërimit, marrin të drejtat, detyrat dhe masën e pages. Përkundrazi veprën edhe me punëtorët e punësuar, me të cilët lidh kontratën e punësimit në përputhje me ligjin " Mbi lidhjen e Kontrates kolektive apo individuale". Në kontratë përcaktohen kushtet e punës për punëtorët dhe administratorët e punësuar. Shoqerija merret për respektive rregullat në fuqi " Mbi Marrëdhëniet e punës" dhe të Sigurimit Shoqëror për ta, me forma stimuluese për punën e tyre, ndërsa për të gjithë të punësuarit janë të detyruar të pranojnë statutin e shoqerise dhe ta respektojnë atë me rëndësi.

## Neni 13

Administratorët nuk mund të marrin cilesinë e ortakut në shoqerine private " Bardhi " dhe as të ushtrojnë aktivitet kontraktues të çdo lloje për llogari të tyre ose të tjetër, për veç rasteve të autorizuara nga pronari i shoqerise. Për shkelje administratorët ose të punësuarit largohen nga puna dhe pergjigjen për çdo dëm.

## Neni 14

Të gjitha shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e të punësuarve përballohen nga vete shoqerija.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

## Neni 15

Perfaqesimi i shoqerise do të bëhet nga pronari i saj dhe prej ad-

ministratoreve eventual te caktuar prej tij si ne qender, ku ajo e ushtron veprimtarine e saj, ashtu edhe ne degjet ne rastet e krijimit te tyre, sipas ketij statuti. Me vendim te pronarit adeministratoret edhe mund te zevendesohen. Ata i zbatohen te gjithë vendimet e pronarit ne kuadrin e detyrimeve te caktuara ne aktin e emerimit apo me rregullore te veçante. Pronari dhe administratori i shoqerise, Z. Josif Bardhi, ka te drejta te perfaqesoje shoqerine private " Bardhi " ne organet gjygesore, ne gjykimet e tjera si dhe para institucioneve shteterore dhe te caktoj Avokat mbrojtës per çeshtjet ne gjykim. Keto te drejta i kanë edhe administratoret e emëruar nga pronari i kesaj shoqerije.

#### SEKRETI I PUNES

##### Neni 16

Te gjithë te emëruarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajine sekretin e punes se shoqerise. Sekret pune paraqesin shkresat, materialet, aktet, te cilet me ligj te veçante, dhe me vendime te nxjerra nga pronari perbejne sekret pune. Te dhenat informative, bilançet, plani si dhe informacioni mbi politiken ekonomike te shoqerise, qe u jepen organeve perkatese, sipas ligjeve, nenshkruhen nga pronari.

Detyrat mbi ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqerija.

#### BILANCI DHE TE ARDHURAT

##### Neni 17

Veprimet ekonomike dhe finaciare te shoqerise " Bardhi " mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti, per veç urdherave te veçante qe jep pronari i shoqerise per kete qellim. Ne fund te periudhes ushtrimore ( mujore dhe tremujore ) shoqerija e administratoret e saj nxjerrin bilancin kontabele te shoqerise me rezultatin fitim dhe humbje, bazuar ne ligjin ne fuqi, dhe ne rregullat e mbajteses se kontabilitetit, qe kerkohen per personat juridik privat dhe shoqerite private nga organet kompetente financiare.

Bilanci kontabele i shoqerise miratohet dhe nenshkruhet nga pronari i saj.

##### Neni 18

Te ardhurat neto, pas veçimit te fondeve te akumulimit dhe pageses se detyrimeve fiskale, i mbeten per perdorim pronarit te shoqerise ose bashkepunetoreve, nese do te kete te tille. Eshte e drejta e pronarit qe te vendose per perdorimin e fondeve nga te ardhurat neto te krijuara. Pjesa e fitimit neto, qe i perket pronarit Shqiptar apo anetareve te tjere te sho-

gerise mund te transefrohet lirisht jashte shtetit Shqiptare, pa kufizim, bazuar ne Ligjin nr.7594 dt.4.8.1992.

SHPERNDARJA E SHOQERISE

Neni 19

Shperndarja e shoqerise mund te kryhet ne qdo kohe dhe per qdo shkak. Pronari i Shoqerise vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdator, duke iu percaktuar detyrat. Administratoret jane per gjegjes per ruajtjen e pasurise se shoqerise, per deri sa tu dorezohet ajo personave fizik dhe juridik, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj personave te trete qe mund te kete shoqerija.

Neni 20

Shoqerija private " Bardhi " ka numerin e llogarise rrjedhese te rregjistruar ne Banken e Shtetit Shqiptar ne Laç.

DISPOZIATA TE PERGJITHESHME

Neni 21

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet qdo ligji te veçante perkates dhe Kodit Civil te RSH dhe veçanerisht Ligjit per shoqerite private nr. 7638 dt.19.11.1992, si dhe Ligjeve te tjere qe do te shpallen per kete qellim.

Neni 22

Ky statut redaktohet ne disa kopje, nga te cilat njeren kopje e mban noteri qe kryen veprimin noterial, nje kopje e mban Gjykate e rrethit te Tiranes, qe kryen rregjistrimin e shoqerise si person juridik, nje kopje i dorezohet zyres perkatese tatimore dhe dokumentet e tjera respektiv me kopjen e fundit te ketij statuti mbeten si pjese e dokumentacionit te shoqerise private " Bardhi " SHPK Laç.

Statuti nenshkrihet rregullisht nga pronari administrator ligjor i shoqerise.

PRONARI DHE AMINISTRATORI LIGJOR I SHOQERISE

PRIVATE " B A R D H I "

JOSIF BARDHI